

PROCEVERBAL I MBLEDHJES 30.09.2025

- I mbajtur sot më datë 30.09.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 15 vota pro.
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Xhuljeta Boriçi, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Arben Hoxha. (Këshilltarët e pranishëm).
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 29.08.2025 dhe procesverbali 04.09.2025 me të gjitha votat e të pranishmëve 15 vota pro.
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Xhuljeta Boriçi, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Arben Hoxha. (Këshilltarët e pranishëm).
- Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:
 1. Miratimi i rendit të ditës.
 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.08.2025 dhe procesverbalin e mbledhjes 04.09.2025
 3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha gusht 2025”.
 4. **P/Vendim** “ Për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit në Bashkinë Librazhd”.
 5. **P/Vendim** “ Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2025”.
 6. **P/Vendim** “ Ndërtim bazamente për urë tip “Baily” HD 30 ML me seksion 1/1 Njësia Administrative Orenjë Bashkia Librazhd”.
 7. **P/Vendim** “Mbështetje financiare për përballimin e fatkeqësisë së krijuar nga zjarri për bashkinë Gramsh”.
 8. **P/Vendim** “Përdorim fondi reserve për prodhim, transport, ngarkim, pastrim, strivim material drusor në ekonominë pyjore Dardhë-Xhyrë dhe Neshtë-Prevallë.
 9. **P/Vendim** “Për dhënie ndihme financiare”.
 10. **P/Vendim** “ Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë”.
 11. **P/Vendim** “ Për miratimin e Kalendarit të Kosultimeve Publike”
 12. **Të ndryshme:**

Fillimi I mbledhjes:

P/Vendimi nr 1 “Mbi dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha gusht 2025”.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

A ka Bashkia ndonjë plan (b) për ti ndihmuar familjet në nevojë me fondet e veta? A e përballojnë dot jetesën këto familje me këtë shumë që marrin?

Fjalën e merr Rexhep Shaka

Bashkia Librazhd gjithmonë I ka ndihmuar familjet ne nevojë dhe ju në qoftë se keni ndonjë rast na e thoni dhe ne jemi të gatshëm që ti vijmë në ndihmë kësaj familje. Bashkia Librazhd dhe në raste të veçanta ka ndihmuar nga buxheti i bashkisë me Ndhimë Financiare familje në vështirësi ekonomike.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Xhuljeta Boriçi, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Arben Hoxha. (Këshilltarët e pranishëm).

2. P/Vendim “Për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit në Bashkinë Librazhd”.

Kryetari i Këshillit, Mitat Biçaku e merr fjalën.

Ne u mbledhëm dje me Komisionet përkatëse ku të pranishëm ishin dhe Administrata e Bashkisë, ku kërkuam dhe disa informacione shtesë dhe sot në mbledhjen e këshillit dokumentacioni është I plotë, në qoftë se keni pyetje shpreheni mendimet tuaja.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Mua nuk më duket normale që mbledhja e këshillit të zhvillohet pa praninë e Kryetarit të Bashkisë ose Zv/Kryetarit. Tani disa kohë më pare ne kemi miratuar dhe atë Paketën e 100 fshatrave turistike dhe që mbas asaj kohe nuk kam shikuar ndonje investim nëper zona ose të diçka në lidhje me këtë paketë, shpresojmë që me Paketën e Maleve të bëhet diçka zerjoze. Në mbledhjen që bëmë dje ramë dakort që të shtojmë dhe Qarrishtën si zone prioritare.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Në lidhje me këtë p/vendim shikoj që ka një disbalancë nëpërmjet Njësive Administrativ , ku shikoj zonën e Hotolishtit ku është kapur shumë përciptasi. A janë bërë dëgjesa publike në lidhje me paketën e maleve?

Këshilltari, Ilir Kuka e merr fjalën;

Shikoj që në paketen e maleve nuk është përfshirë fare zona e Funarsit ,ku besoj duhet të ishte patjetër sepse në atë zone ka shumë vende turistike.Dhe kisha diçka tjetër ku po në atë zone i është dhene me qera apo në përdorim 1000 metra katror tokë dikujt me patedrejte dhe pa bërë ndonje konsultim me banorët.

Sekretari I Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Sot mbas miratimit të këtij p/vendimi ne hedhim hapat e para pasi janë dhe disa hapa të tjerë deri sa të shkojë punë të investimi.Do miratohet dhe lista me emrat përkatëse dhe po kb e miraton.Lista do jetë e hapur dhe kush të dojë të propozoj dhe zona të tjera.

Këshilltari, Bujar Vreto e merr fjalën.

Ne duhet të mendojmë si të zhvillojmë zonat tona dhe Investitorë të jenë të zonave të Librazhdit,se siç e dime të gjithë nga Librazhdi ka shumë pak që mund të investojnë në keto zona.Librazhdit sa vjen dhe I bie numri I popullsisë dhe ne duhet të mendojmë diçka që si këta njerëz mos ikin nga Librazhdi por të investojnë në vendin e tyre.

Këshilltarja,Xhuljeta Boriçi e merr fjalën;

Për dhenien e tokës me qera dhe pastaj në pronësi dhe mbas kësaj që ne miratojmë e bëjmë pronar,Duhet vërtetuar me një document që kush vërtetë e ka si pronë.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 17 vota pro.

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Xhuljeta Boriçi,Flutur Kojku,Bledi Koçi,Veli Terziu,Fiqirete Alliu,Ilir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Arben Hoxha,Arjana Çekrezi,Erjola Albrahimi.(Këshilltarët e pranishëm).

3.P/Vendim“Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2025”.

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Këshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 28.05.2025 “ Ka miratuar për investim palestren e shkolles “ Vilson Blloshmi” dhe sot atje nuk zhvillohet mësim, a nuk do ishte më e mira që ky investim të mire mendohej pas nxënësit e shkollës po e bëjnë mesimin mbasdite.

Këshilltari,Zenel Bahiti e merr fjalën;

Si fillim ju përgëzoj për punën voluminoze që keni bërë.Nga këto investime që janë përmendur sa janë realizuar ose sa kanë përfunduar dhe sa janë në proces? Nga ku jeni nisur ose bazuar që plani I të ardhurave është në rritje? Kush projekte do të preken?

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Duke shikuar numrin e punonjësve të Bashkisë që është fakt 450 dhe pse ka ngelur 86% pagesa e punonjësve?

Këshilltari, Ilir Kuka e merr fjalën;

Shikoj në lidhje me shkollën e Funarsit që nuk ka investim pse e keni lënë bosh te këto tabelat? Në kanalin vaditës Orenjë nuk është bërë asnjë investim dhe ne fund I është venë një plasmas. Dhe rruga e Prevallit mos ka ndonjë ngatërres sepse shumat nuk përputhen?

Këshilltarja ,Arjana Çekrezi e merr fjalën;

Fondi për shpërndarjen e higjeno sanitareve kur fillon?

Drejtoresha e Financës, Albana Hoxha e merr fjalën;

Në lidhje me pyetjet e drejtuara;Fondi për shpërndarjen e higjeno sanitareve është çelur dhe besoj mbrenda javës do të bëhet dhe shpërndarja. Në lidhje me pagesën e punonjësve është në vlerën 86% pasi në atë koha ndodhi dhe ndryshimi I nivelit të pagave dhe çdo gjë është sistemuar tashmë.Për sa I perket kanaleve vaditese nuk është e vertet që nuk ka pasur investim pasi cdo punë që bëhet verifikohet nga specialistët e zyrës dhe merret në dorzim,në lidhje me shkollën ne kemi pritur një Financim nga Këshilli i Qarkut deri tani prandaj dhe tabela është lë boshë, por besojmë që nëpërmjet donatorëve të huaj ta bëjmë të mundur këtë investim.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **18 vota pro.**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Xhuljeta Boriçi,Flutur Kojku,Bledi Koçi,Veli Terziu,Fiqirete Alliu,Ilir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Arben Hoxha,Arjana Çekrezi,Erjola Albrahimi,Silvana Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

4. P/Vendim“Ndërtim bazamente për urë tip “Baily” HD 30 ML me seksion 1/1 Njësia Administrative Orenjë Bashkia Librazhd”.

Sekretari I Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Ministria e Mbrojtjes ka miratuar për Bashkinë Librazhd tre ura dhe na sjellin konstruksionin metalik dhe ne si bashki duhet të ndërtojmë këmbët e urës.Ku kemi dhe fondet e Emergjencave Civ ile dhe këto fonde në fund do të digjen.Më pas ne do sjellim për miartim e hapjes rrugës auto.

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.

Unë e kam prekur atë vend ku bëhet fjalë për ndërtimin e urës dhe për të shkuar të kjo urë është e vërtetë që nuk ka rrugë por ajo urë është shumë e domosdoshme për banorët e zones.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Kam një falenderim për Sekretarin e Përgjithshëm ku vërtet na bënë një shpjegim shumë të saktë.

Këshilltari, Ilir Kuka e merr fjalën;

Që të shkosh tek vendi që ju keni menduar të beni urën më pare duhet bërë rruga pasi nuk ka rrugë që të shkonë tek vendi që do ndërtohet ura.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me **të gjitha votat e të pranishmëve 18 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Xhuljeta Boriçi, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Arben Hoxha, Arjana Çekrezi, Erjola Albrahimi, Silvana Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

5.P/Vendim“Mbështetje financiare për përballimin e fatkeqësisë së krijuar nga zjarri për bashkinë Gramsh”.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Si gjithmonë Bashkia Librazhd është solidare për të ndihmuar dhe e falenderojmë Bashkinë për këtë ndihmë që po i japim Bashkisë Gramsh.

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

A ka Bashkia fond që ti shpërblej me një page punonjsit e Zjarrfikses sepse me të vërtetë bëjnë një punë shumë të vështirë?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Ne po presim që fondi për shpërblimin e punonjësve të zjarrfikses të na vi nga Ministria, ku vërtetë bëjnë një punë shumë vështirë dhe të lodhshme.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me **të gjitha votat e të pranishmëve 18 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Xhuljeta Boriçi, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Arben Hoxha, Arjana Çekrezi, Erjola Albrahimi, Silvana Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

6.P/Vendim “Përdorim fondi reserve për prodhim,transport,ngarkim,pastrim,shivim material drusor në ekonominë pyjore Dardhë-Xhyrë dhe Neshtë-Prevallë.

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Ju e keni lidhur një kontratë në muajin gusht me një subjekt tjetër dhe tani ky subjekti i ri cfarë fitimi do të ketë që I sjellë me këtë çmim?Ju keni lidhur një kontratë tani cfarë po kërkon që kjo kontratë të shtyhet?

Sekretari I Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Ne kemi marrë miratimin e këtyre ngastrave dhe për vitin 2026 ne mund të rrezikojmë që të ngelemi pa dru zjarri për kopshtet ,çerdhet dhe shkollat.Operatori fitues mund të bëjë të mundur transportin e druve,por ne na nevojitet prerja,çarja dhe stivosja.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **17 vota pro.**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Xhuljeta Boriçi,Flutur Kojku,Bledi Koçi,Fiqirete Alliu,Ilir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Arben Hoxha,Arjana Çekrezi,Erjola Albrahimi,Silvana Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

7.P/Vendimi “Për dhënie ndihme financiare”.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

A ka mundësi Bashkia që ky fond të rritet?

Drejtoresha e Financës, Albana Hoxha e merr fjalën;

Ne e kemi diskutuar dhe e dime shumë mire gjendjen që ndodhet familja Ziko por mundësit e bashkisë kaq janë.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Xhuljeta Boriçi,Flutur Kojku,Bledi Koçi,Fiqirete Alliu,Ilir Kuka,Adelina Alla,Arben Hoxha,Arjana Çekrezi,Erjola Albrahimi,Silvana Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

8. P/Vendim “ Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë”.

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Ne duhet të kemi informacionin e duhur të kemi hartat dhe kartelat pëkatëse pasi mund të kemi dhe mbivendosje .

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 14 vota pro dhe 1 kundër.

Votat pro; Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Arben Hoxha, Arjana Çekrezi, Erjola Albrahimi, Silvana Hoxha.

Votat kunder; Xhuljeta Boriçi

9. P/Vendim “ Për miratimin e Kalendarit të Kosultimeve Publike”

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Xhuljeta Boriçi, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Arben Hoxha, Arjana Çekrezi, Erjola Albrahimi, Silvana Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU

